



Nëse dëshironi të flisni me dikë përpara regjistrimit, na dërgoni me email deklarimet e mëposhtme që renditen në anglisht. Në këtë mënyrë ne informohemi se duhet të marrim një përkthyes/e në telefon për të folur me ju.

Tema e mesazhit: *Interested in joining Survivor Alliance*

Mesazhi:

Hi, my name is [vendosni emrin] and I want to speak with someone about the Survivor Alliance. I speak [vendosni gjuhën] language.

I am able to speak the following dates and times:

[Vendosni datën dhe orën në të cilën mund të flisni. Na jepni 3 alternativa. Na tregoni zonën kohore ku ndodheni dhe kini parasysh se ne jemi me orën e Mbretërisë së Bashkuar]

MISIONI

Të bashkojmë dhe të fuqizojmë të mbijetuarit e skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore në botë

KUSH JEMI DHE ÇFARË BËJMË?

- "Survivor Alliance" është një organizatë joqeveritare dhe bamirëse që bashkon dhe fuqizon të mbijetuarit e skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore në botë.
- Ne po krijojmë një rrjet global të udhëheqësve të të mbijetuarve, të cilët janë angazhuar të punojnë në luftën kundër skllavërisë ose që janë të interesuar të

angazhohen.

- Ne mbështesim zhvillimin e rrjeteve lokale për të mbijetuarit, si dhe do të lidhim rrjetet ekzistuese përtej kufijve të qyteteve, shteteve dhe kombeve.
- Ne sigurohemi që zëri i të mbijetuarve të jetë thelbësor në përpjekjet kundër skllavërisë. Kur është e mundur, ne do të mbështesim dhe do të lehtësojmë përfshirjen e të mbijetuarve.
- Anëtarësimi është pa pagesë për të gjithë individët që vetëdeklarohen si të mbijetuar nga skllavëria apo trafikimi i qenieve njerëzore me vendbanim në çdo vend, për sa kohë që keni qasje në email ose një numër telefoni.

ANËTARËSIMI

Çfarë nënkupton anëtarësimi në "Survivor Alliance"?

- Bëhuni pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të të mbijetuarve nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe skllavëria.
- Përfitoni qasje pa pagesë në hapësirën dixhitale online të komunitetit për t'u lidhur me udhëheqës të tjerë të të mbijetuarve.
- Zgjidhni buletin tonë të emailit, ku ne përcjellim burime dhe mundësi për udhëheqje.
- Merrni pjesë vetëm në ngjarje opsionale për të mbijetuarit
- Ju duhet të mbronit deklaratën e anëtarësimit dhe na ndihmoni të krijojmë një rrjet bashkëpunues ndërkombëtar për të mbijetuarit.

Deklarata e anëtarësimit

Lexoni me kujdes secilën prej këtyre deklarimeve. Ne u kërkojmë të gjithë anëtarëve që duan të anëtarësohen te ne që t'i mbrojnë ato si bindjet tona më të rëndësishme.

Ne besojmë në të folurit me njëri-tjetrin dhe jo për njëri-tjetrin.

Ne jemi zëri i atyre që nuk e ngrenë zërin. Secili nga ne ka diçka për të thënë. Disa shprehen përmes të folurit në publik ose shkrimit, disa përmes veprimit në komunitet dhe të tjerët përmes mediave krijuese si arti ose fotografia. Ne flasim nga përvojat tona dhe fuqizojmë njëri-tjetrin që zëri ynë të dëgjohet.

Ne e pranojmë se përvojat tona janë unike dhe të ndryshme.

Ne e pranojmë se përkufizimi i Kombeve të Bashkuara për trafikimin e qenieve njerëzore është i gjerë dhe çdo përvojë e të mbijetuarve është vështirë që të përfaqësojë të gjitha format dhe dinamikat e trafikimit të qenieve njerëzore. Prandaj, ne përpiqemi të bashkohemi në mënyrë që të edukojmë njëri-tjetrin mbi larminë e përvojave tona dhe të lidhim të mbijetuarit më të përshtatshëm me çdo mundësi.

Ne besojmë se fuqia e fjalës "ne" është më e fortë se fuqia e fjalës "unë".

Me një grup kaq të madh dhe të ndryshëm të të mbijetuarve, ne mund të mos biem gjithmonë dakord. Megjithatë, kur biem dakord, zëri i përbashkët na lejon t'ju bëjmë presion ligjbërësve, të qëndrojmë së bashku kundër padrejtësisë, të grupojmë burimet tona dhe shumë më tepër.

Ne fillimisht do t'i japim prioritet shëndetit dhe mirëqenies.

Ne e pranojmë rëndësinë e udhëheqjes duke dhënë shembullin e mirë. Për të qenë udhëheqës, aktivistë, këshillues dhe anëtarë komuniteti efektivë, ne fillimisht do t'i japim prioritet shëndetit dhe mirëqenies.

Ne do të promovojmë një qasje me informacione për traumat.

Ne e dimë se ngjarjet traumatike janë të zakonshme në botë. Si rrjedhojë, ne e kuptojmë se çdo person, jo vetëm të mbijetuarit e trafikimit njerëzor, mund të pësojnë efekte afatgjata nga trauma. Prandaj, ne do të promovojmë një qasje me informacione për traumat në të gjitha rastet, duke përfshirë dhe veçanërisht çdo rast që ka të bëjë me një të mbijetuar nga trafikimi i qenieve njerëzore.

Ne do të promovojmë unitetin dhe mbrojtjen nga përçarja.

Me një grup kaq të madh dhe të ndryshëm të të mbijetuarve, ne e kuptojmë se personalitetet dhe perspektivat mund të përplasen. Mbi të gjitha, ne do të gjejmë interesat e të përbashkëta në viktimizimin tonë të kaluar dhe qëllimin tonë për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të fuqizuar të mbijetuarit. Ne presim që të gjithë të promovojnë unitetin dhe të mbrohen nga përçarja.

Ne angazhohemi të punojmë midis sfidave dhe konflikteve me respekt.

Ne besojmë se dallimet në këndvështrime janë normale dhe të dobishme. Megjithatë, kur shfaqen sfida dhe konflikte, ne do t'iu përgjigjemi në mënyrë profesionale dhe do të përpiqemi t'i zgjidhim ato në mënyrë civile dhe me respekt. Ne nuk promovojmë një kulturë sulmi. Ne i nxisim të mbijetuarit të bisedojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin për mosmarrëveshjet. Nëse konflikti nuk mund të zgjidhet, ne presim që të gjitha palët të vazhdojnë të sillen në mënyrë profesionale dhe miqësore.

Ne e kuptojmë se të gjithë kanë një rol të rëndësishëm në lëvizjen kundër skllavërisë dhe kundër trafikimit.

Ne besojmë se të gjithë të mbijetuarit mund të luajnë një rol në lëvizjen kundër skllavërisë dhe kundër trafikimit, nëse ata dëshirojnë. Nuk ka asnjë kërkesë për ta bërë këtë dhe nuk ka asnjë kusht për të qenë në sytë e publikut. Çdo i mbijetuar është në një udhëtim unik dhe duhet të vendosë vetë se si dëshiron të përfshihet ose nëse dëshiron të përfshihet.

Kërkesat për anëtarësimin

- ✓ Unë vetidentifikohem si një i mbijetuar nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe/ose skllavëria.

Lidhja për te:

[<https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/what-is-human-trafficking.html?ref=menu-side>]

Trafikimi i qenieve njerëzore: "Trafikimi i qenieve njerëzore" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikatat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.

Skllavëria: "Skllavëria është statusi ose gjendja e një personi mbi të cilin ushtrohet ndonjë ose të gjitha fuqitë që i bashkëngjiten të drejtës së pronësisë".

- ✓ Jam mbi 18 vjeç.
- ✓ Unë marr pjesë si individ dhe jo si përfaqësues i ndonjë organizate.
- ✓ Jam i gatshëm të jap emrin, mbiemrin dhe një adresë të vlefshme emaili.
- ✓ E kuptoj që "Survivor Alliance" nuk ofron shërbime të drejtpërdrejta si strehimi, terapia apo mbështetja ligjore, por do të ofrojë referime.

Pyetje për regjistrimin e anëtarësisë

Faleminderit për interesimin tuaj për t'u bërë pjesë e "Survivor Alliance"! Përpara se të plotësoni këtë formular, dëshirojmë që të dini se të dhënat specifike dhe personale që ndani me ne do të mbahen konfidenciale, përveç nëse na autorizoni për shpërndarjen e tyre.

Megjithatë, të dhënat do të shtohen dhe do të ndahen në mënyrë anonime me publikun duke përdorur deklaratime të tilla si: "25% e numrit të këshilltarëve të "Survivor Alliance" janë nga vendi X" ose "57% e numrit të këshilltarëve mbajnë fjalime kryesore".

Gjithashtu, të dhënat që jeni të gatshëm t'i ndani me të mbijetuarit e tjerë do t'i jepen AnnieCannons, një OJQ që shërben si zhvilluesi ynë i faqeve të internetit. AnnieCannons i punëson dhe trajnon të mbijetuarit nga trafikimi i i qenieve si zhvillues të faqeve të internetit (<https://www.anniecannons.org/>).

Emri dhe mbiemri _____ (Kërkohet)

Adresa e emailit _____ (Kërkohet)

Cilat nga termat e mëposhtëm përdorni për të përshkruar përvojën tuaj? (Kërkohet)

(Shënoni të gjitha ato që vlejnë)

- Skllavëri
- Trafikim i qenieve njerëzore
- Punë e detyruar
- Punë skllavëruese
- Shërbime shtëpiake të detyruara
- Fëmijë ushtarë
- Skllavëri borxhi
- Martesë me dhunë
- Shfrytëzim seksual tregtar i fëmijëve për qëllime përfitimi (CSEC)
- Shfrytëzim seksual
- Shfrytëzim për punë
- Tjetër: _____

Aktualisht po ofroj shërbime të të folurit, trajnime ose këshillime në fushën kundër skllavërisë/kundër trafikimit. (Kërkohet)

- Po
- Jo
- Jo, por dëshiroj të

Në cilin qytet dhe/ose shtet jetoni? (Opsionale)

Në cilin vend jetoni? (Kërkohet)

Shënoni çdo kërkesë anëtarësimi që vlen për ju. (KËRKOHET)

Jam mbi 18 vjeç.

Po bëhem pjesë e "Survivor Alliance" si individ dhe jo si përfaqësues i ndonjë organizate.

Unë kam lexuar deklaratën e anëtarësimit.

Jam dakord që stafi i "Survivor Alliance" të verifikojë duke me pyetur, nëse mendon se nuk

po respektoj deklaratën e anëtarësimit.

Do të dëshiroja të merrja këshillim pa pagesë për biografinë time personale.

- Po
- Jo

Do të dëshiroja të merrja këshillim pa pagesë për biografinë/CV-në time.

- Po
- Jo

Ne do të dërgojmë një buletin mujor me përditësimet më të fundit dhe më të rëndësishme nga "Survivor Alliance", duke përfshirë; a) mundësitë për këshillim dhe/ose zhvillim profesional dhe b) burimet dhe informacionet e lëvizjes kundër skllavërisë.

A do të dëshironit të merrnit këtë buletin? (Kërkohet)

- Po, më dërgoni buletin!
- Jo, nuk dëshiroj të marr përditësimet mujore

Keni pyetje të tjera për ne? _____